



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 03.04.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-01

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë: Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Ramë Vataj, Xhevahire Izmaqu, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Afrim Kasolli, Teuta Haxhiu dhe Jeton Svirca, ndërsa mungoi: Milivoje Stojanovic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 27.02.2013;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, nr. 04/L-137;**
- 4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe Projektligjin për administrimin e punës në zyrë;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit të Grupit Punues për monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës**
- 6. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari i komisionit - kërkoi që pika e gjashtë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

Sadri Ferati – kërkoi që e pika e tretë të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyetimin e përgatitjes me të mirë për shqyrtim.

Teuta Haxhiu – përkrahu propozimin e znj. Lama edhe pse ajo u deklarua se ishte e përgatitur për shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës, komisioni vazhdoi me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës.

Komisioni miratoi rendin e ditës, me miratimin e propozimeve për heqjen e pikës së tretë dhe të gjashtë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 27.02.2013

Procesverbali u miratua me vërejtjen e znj. Teuta Haxhiu, diskutimi i saj nga mbledhja e kaluar, lidhur me projektligjin për shoqërinë e informacionit në organet qeveritare nuk ishte inkorporuar në procesverbal.

4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe Projektligjin për administrimin e punës në zyrë;

Kryetari i komisionit, konfirmoi se për projektligjet e sipërsëhënuara nuk ka vërejtje apo propozime nga komisionet kryesore në raportin me rekomandime të komisionit funksional.

Komisioni unanimisht vendosi që raportet me rekomandime të projektligjeve për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe Projektligjin për administrimin e punës në zyrë, të procedohen për shqyrtim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Raportit të Grupit Punues për monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kryetari i komisionit, për këtë pikë të rendit të ditës, ia dha fjalën znj. Xhevahire Izmaku, në cilësinë e kryesueses së grupit punues për monitorimin e Ligjit për shërbimin civil.

Xhevahire Izmaku- prezantoi para komisionit punën e grupit punues për monitorimin e Ligjit për shërbimin civil. Ajo tha se në bazë të gjeturave gjatë monitorimit të ligjit grupi punues ka nxjerr dhjetë rekomandime si vijon:

- Të hartohen dhe miratohen pjesët e mbetura të legjislacionit sekondar që kërkohet me Ligjin për shërbimin civil, veçanërisht në lidhje me:
 - Mundësitë e barabarta për pranim në shërbimin civil;
 - Procedurat për zbatimin e programeve të veçanta për ngritje të kapaciteteve dhe ngritjen në karrierë; dhe
 - Saktësimin e pozitave kyçe që nuk mund të plotësohen nga të huajt.
- T'u ofrohen shërbyesve civilë, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil, shkresat për emërim pa afat të caktuar në institucionet e nivelit lokal

dhe qendror, aty ku ky proces nuk ka përfunduar ende, në pajtim me nenin 96 të Ligjit për shërbimin civil.

- Të definohet çështja kur një Kryetar Komune dhe administrata e tij, nuk zbatojnë vendimet detyruese të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC). Si pasojë e mos respektimit, ankesat po procedojnë në gjykata dhe pastaj koha e kompensimit material të nëpunësit që jo ligjërisht është larguar nga puna, po bëhet çështje ne vete. Vetëm nga këto raste, Komuna të caktuara shpenzojnë shuma të mëdha parash nga buxheti komunal.
- Regjistri Qendror për Nëpunës Civil duhet të funksionojë sipas Ligjit për shërbimin civil dhe numri i shërbyesve civil të përputhet me numrin e atyre që marrin pagë mujore dhe që disa nuk figurojnë në regjistër si shërbyes civil. Konform kësaj, duhet të rregullohet çështja e koeficientëve për të gjithë zyrtarët sipas gradave dhe kategorive që përcaktohen me Ligj dhe me Rregullore. Duhet të ndalet mënyra kur një shërbyes civil me përkrahje të njëjtë të detyrave të paguhet më shumë se sa shërbyesi tjetër me përkrahje të njëjtë të detyrave.
- Kategoritë që nuk janë pjesë e shërbimit civil duhen të klasifikohen me akt nënligjor. Kategoritë e zjarrfikësve të trajtohen me status tjetër prej shërbyesve civil pasi natyra e punës së tyre dallohet nga ajo e shërbyesve civil. Meqë kohëve të fundit kompetenca e menaxhimit me brigadat zjarrfikëse ka kaluar në kompetencë të Agjencionit për Menaxhim Emergjent (në kuadër të MPB-së), kjo kategori e punonjësve duhet të rregullohet nga ky institucion.
- Të formohen njësitë për menaxhimin e personelit, në nivelin lokal aty ku ky proces nuk ka përfunduar ende.
- Të rishikohet pozicioni i komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali i cili është i nënpërfaqësuar.
- Përfaqësimi gjinor është jo i mjaftueshëm në administratën e nivelit lokal sa i përket pozitave menaxheriale dhe ky aspekt ka nevojë të ndryshohet.
- Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të miratojë Rregulloren për Orarin e punës dhe kompensimin e nëpunësve civil të Kuvendit.
- Të ndërtohet një mekanizëm ndëshkues për moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Pas prezantimit të rekomandimeve, ajo kërkoi nga anëtarët e komisionit që të propozojnë apo plotësojnë raportin apo të japin ndonjë vërejtje.

Teuta Haxhiu – sugjeroi që rekomandimi i tretë të plotësohet si vijon: që të definohet çështja kur institucionet nuk i zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Sadri Ferati – tha se raporti ka arrit me i sintetizuar të gjeturat dhe rekomandimet, por

shqetësuese është indiferenca në moszbatimin e vendimeve të KPMSHCK-së dhe mbi këtë bazë ai propozoi iniciativën për plotësim - ndryshimin e Ligjit për KPMSHCK, tek dispozitat ndëshkuese.

Jeton Svirca – propozoi plotësimin e rekomandimit si vijon: komisioni, edhe njëherë, të kërkon zbatimin e vendimeve të KPMSHCK-së.

Pas propozimeve të anëtarëve të komisionit me riformulimin e disa e rekomandimeve të raportit, komisioni miratoi raportin e grupit punues për monitorimin e Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe Kuvendit ia paraqet këtë:

R E K O M A N D I M

I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me rekomandimet si në vijim:

1. Qeveria – Ministria e Administratës Publike të nxjerr aktet nënligjore të parapara me Ligjin për shërbimin civil, veçanërisht në lidhje me:
Mundësitë e barabarta për pranim në shërbimin civil;
2. Gjatë fazave të rekrutimit dhe avancimit në të gjitha pozitat të respektohet parimi i mosdiskriminimit dhe Ligji për barazi gjinore.
3. Ministria e Administratës Publike ti rishikojë të gjitha dosjet e të punësuarve dhe për këtë të krijojë regjistrin qendror konform nenit 8 të Ligjit për shërbimin civil.
4. Të gjithë nëpunësve civilë, në institucionet e nivelit lokal dhe qendror, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 96 të Ligjit për Shërbimin Civil, tu ofrohen shkresat për emërim konform ligjit.
5. Të formohen njësitë për menaxhimin e personelit, në nivelin lokal aty ku ky proces nuk ka përfunduar ende.
6. Rekrutimi i nëpunësve civil nga radhët e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkalinj, të bëhet në pajtim me nenin 11, paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit për Shërbimin Civil.
7. Qeveria në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit për Shërbimin Civil, ti përcakton pozitat që nuk mund të plotësohen nga të huajt.
8. Institucionet e nivelit lokal dhe qendror ti zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC).

7. Të ndryshme;

Teuta Haxhiu - kërkoi që të fillohet me monitorimin e Ligjit për arsimin e lartë, ajo kërkoi mbështetjen e komisionit për formimin e grupit punues.

Idriz Vehapi – propozoi që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës pasi të përfundohet me universitetet e reja.

Xhevahire Izmaku – kërkoi që ti dërgohet një shkresë Kryesisë së Kuvendit, lidhur me mënyrën e vazhdimet të pozitës së z. Shefki Ukaj, në postin e Kryetarit të KPM-së.

Mbledhja përfundoi në ora:12:30.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**